

PROCESVERBALI

nga mbledhja e gjashtë e rregullt të Komisionit për përmbajtjet programore në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e pjesëtarëve të popujve tjerë pakicë dhe bashkësive tjera nacionale.

Mbledhja e Komisionit u mbajt me 14 09 2022.

Në mbledhje morën pjesë:

1. Admir Adroviq, kryetar;
2. Veron Halili, anëtar;
3. Tripo Matijeviq, anëtar;
4. Ivana Krushçiq, anëtare;

Frashër Selimaj, anëtar dhe Mirheta Gaçeviq, anëtare nuk morën pjesën mbledhje për shkak të obligimeve të mëparshme, për çgjë e njoftuan kryetarin e Komisionit.

Krahas anëtarëve të Komisionit, në mbledhje mori pjesë edhe Ivan Lekoviq, sekretari i Komisionit.

Në mbledhje u miratua

RENDI I DITËS

1. Diskutim dhe deklarim lidhur me Procesverbalin e mbledhjes së pestë të rregullt të Komisionit;
2. Analiza e raportit për realizimin e Planit programor dhe të produksionit të TVMZ dhe RMZ për periudhën janar- qershor 2022;
3. Të ndryshme.

I

Procesverbali nga mbledhja e pestë e rregullt e Komisionit u miratua me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm. (4 vota PËR)

II

Plani Programor dhe i produksionit i TVMZ: Tripo Matijeviq ka shprehur keqardhje që emisionet të cilat ishin planifikuar nuk janë realizuar. Është konstatuar se gjashtë muaj është periudhë e gjatë dhe se është dashur të realizohen të paktën një numër i caktuar i emisioneve. Krahas kësaj, zvogëlimi i numrit të emisioneve të “Lajmet” është hap mbrapa. Ai konsideron se nuk është në rregull që emisioni informativ të mungojë të dielave, kur do të ishte shikueshmëria më e lartë. Admir Adroviq theksoi se emisioni, “Mostovi” emetohet në interval të shkurtër që është i papranueshëm, 25 minutash, faktikisht 20 minuta dhe se do të duhej të punohej në drejtim që minutazhi i këtij emisioni të shtohej. Ivana Krushçiq u pajtua me këtë. Tripo Matijeviq thotë se tre të punësuar, sa numëron redaksia, do të duhej të mjaftojnë që emisioni në fjalë të zgjasë 45 minuta. Gjithashtu konsideron se do të duhej të dërgohej një thirrje për vitin e ardhshëm. Krahas të cekurave, janë të mendimit se ekziston një hendek e madh mes 44 emisioneve të planifikuara në 52 javë gjatë vitit kalendarik. Ivana Krushçiq ishte e mendimit se kjo është për shkak të pauzës verore e cila zgjatë 2 muaj. Tripo Matijeviq konsideron se pikërisht në muajt e verës, duke pasur parasysh publikun që e mbulon, kur është në kulmi i sezonit

turistik, me numër të madh të festivaleve dhe manifestimeve tjera, duhet të përcjellët me sa më shumë raporte. Nga ana tjetër, muaji Janar dhe Shkurt nuk ofrojnë mundësi të tilla dhe për këtë arsye mund të paraqesin problem lidhur me materialet për emisione. Ai propozon që pauza verore, nëse është e domosdoshme, të jetë disa javë.

Plani Programor dhe i produksionit i RMZ: Admir Adroviq theksoi se për emetimin e lajmeve të mëngjesit në gjuhën shqipe janë planifikuar 361 emetime, ndërsa janë realizuar 128, që do të thotë 60 më pak se sa ishte planifikuar. Gjithashtu, Ditari në gjuhën shqipe nga 261 të planifikuar, janë realizuar vetë 128, që gjithashtu është më pak për rreth 60. Krahas kësaj nuk është e qartë se si janë planifikuar 361 emetime të lajmeve, nëse ato realizohen vetëm në ditët e punës, me pauzë gjatë muajve të verës. Tripo Matijeviq theksoi se duke pasur parasysh se lajmet emetohen një herë në ditë me nga 5 minuta, mund të tejkalohet mungesa e spikerit nga RMZ me kolegun nga TVMZ dhe anasjelltas, në periudhën e verës. Ivana Krushçiq theksoi se emisioni, “Spona” është realizuar në numrin më të vogël se sa ishte planifikuar, në periudhën janar-qershor, dhe konsideron se në raport do të duhej të theksohej arsyen e se pse ka ndodhur që të mos realizohen emisionet. Tripo Matijeviq konsideron se në raportin e RMZ duhet të qëndrojë krahas emisionit edhe sa minuta janë realizuar, siç është rasti te raporti i TVMZ.

III

Në kuadër të pikës të rendit të ditës, Të ndryshme, janë shqyrtuar përgjigjet e Këshillit dhe Menaxhmentit të RTMZ ndaj iniciativave të cilat Komisioni i ka dërguar në mbledhjen e kaluar. Ivan Lekoviq i njoftoi se iniciativa e parë, e cila kishte të bënte ndaj lëshimeve në realizimin e programit, është shqyrtuar në mbledhjen e Këshillit dhe se përgjigja për këtë do

U okviru taçke razno razmatrani su odgovori Savjeta i Menadžmenta RTCG na dorëzohet pas miratimit të Procesverbalit nga ajo mbledhje, respektivisht në mbledhjen e ardhshme të Këshillit. Dy iniciativat tjera me këtë rast u janë dërguar Menxhmentit të RTMZ. Admir Adroviq i lexoi iniciativat nga 12 gushti. Pasi që menaxhmenti i RTMZ në përgjigje theksoi se me planin financiar për vitin 2022 nuk është planifikuar punësimi e personave në kohë të caktuar, të cilët do të jenë zëvendësim për të punësuarit të cilët mungojnë, për shkak të pushimeve mjekësore dhe arsyeve tjera, Tripo Matijeviq propozoi që të iniciohet që kjo të përfshihet në planin financiar për vitin 2023. Ivana Krushçiq theksoi gjithashtu se se duhet të vihet pika për punësimin e personave të cilët do të kryenin punë në formë të honorarit. Gjithashtu, për sa i përket iniciativës së dytë, për prokurimin e pajisjeve kompjuterike për të punësuarit në redaksi, pasi Admir Adroviq lexoi përgjigjen e Menxhmentit, se është në procedurë tenderi dhe se do të sigurohen pajisjet kompjuterike edhe për të punësuarit tjerë, anëtarët e Komisionit nuk patën komente tjera.

Krahas të cekurave, nën pikën, Të ndryshme është biseduar edhe për punën e vet Komisionit, organizimit të mbledhjeve, mungesës dhe pyetjeve tjera, për çgjë është arritur marrëveshja mes anëtarëve të pranishëm.

PROCESVERBALIN E MBAJTI
Ivan Lekoviq

KRYETARI I KOMISIONIT
Admir Adroviq